



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 28 datë 11.06.2025

PËR

MIRATIMIN E LEJES Së NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “OBJEKT BANIMI DHE SHËRBIMESH 1, 11, 13, 14 DHE 17 KATE ME 1-3 KAT PARKIMI NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË PASKUQAN, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese shoqërisë “AB Vizion” sh.p.k dhe “Darsi Construcion” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Objekt banimi dhe shërbimesh 1, 11, 13, 14 dhe 17 kate me 1-3 kat parkimi nëntokë”, me vendndodhje në Paskuqan, Bashkia Tiranë, me subjekte zhvilluese shoqëritë “AB Vizion” sh.p.k dhe “Darsi Construcion” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuarit vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI R. R. MA



MINISTËR I LINIËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU

ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA

Nënshkruar më datë ____/____/2025